



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Qeveria /Vlada/Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Ministarstvo Trgovine i Industrije/Ministry of Trade and Industry

Departamenti i Industrisë

Department Industrije/Department of Industry

RAPORTI PËR ZHVILLIMET NË INDUSTRIJË E KOSOVËS PËR VITIN 2016

Volumi i V-të

Tetor, 2017

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrje	4
Metodologjia	5
Analiza sektoriale	6
Numri i të punësuarave sipas sektorëve të prodhimit industrial në nivel Kosovë, 2012-2016.....	8
Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial në Kosovë, 2012-2016.....	9
Analiza makroekonomike.....	10
Struktura e të Hyrave të Përgjithshme të Qeverisë, 2015-2016.....	12
Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	123
Investimet e Huaja Direkte sipas Shteteve	14
Tregu financiar	166
Tregtia e Jashtme	168
Fuqia punëtore.....	23
Konkludimet.....	24

Lista e shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

BKK - Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

BPV - Bruto Prodhimi Vendor

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DI – Departamenti i Industrisë

DK - Dogana e Kosovës

DPI - Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale

IHD - Investimet e Huaja Direkte

IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

IÇP - Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTLEQ – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore

NMVID - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita

NMVIK - Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Kredi

Hyrja

Divizioni për Politika Industriale (DPI), në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ka për mandat edhe rolin e monitorimit dhe analizimit të trendëve të zhvillimit të industrisë në Kosovë. Në këtë drejtim është ndërtuar një traditë në përgatitjen e raporteve vjetore statistikore dhe analitike mbi zhvillimin e aktiviteteve industriale, dhe ky është raporti i pestë me radhë.

Qëllimi i përpilimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendeve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, me theks të veçantë në degët kryesore industriale gjatë vitit 2016, por edhe një analizë krahasuese për dy vitet e fundit si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë për periudhën kohore 2012-2016.

Paraqitja e të dhënave në këtë raport është menduar që t'iu shërbejë politikë-bërësve në procesin e zhvillimit ekonomik në Kosovë si dhe hisedarëve tjerë të sajë siç janë: bizneset operuese, (të tanishme dhe ato potenciale nga sektori privat), investitorëve të huaj, donatorëve, hulumtuesve akademik, etj. Më konkretisht, përmes këtij Raporti, i cili ofron një pasqyrë më të qartë rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit, do t'iu lehtësohet puna të gjithë akterëve përkatës në përpilimin e politikave zhvillimore më të efektshme, përveç tjerash, bazuar në indikatorë të matshëm.

Përveç indikatorëve kryesor të nivelit sektorial/industrial (qarkullimi, numri i të punësuarave dhe ndërmarrjeve), në këtë Raport, janë përfshirë edhe indikatorët e nivelit makroekonomik, ata të tregut financiar, tregut të punës, pastaj Investimeve të Huaja Direkte si dhe tregtia e jashtme, të cilët ndikojnë në zhvillimin industrial në një mënyrë apo tjetër.

Metodologjia

Qasja e përpilimit të Raportit për zhvillimet në industrinë e Kosovës, për vitin 2016, i takon asaj përkrahëse dhe pozitive. Me këtë rast analistët e DPI-së kanë tentuar që të vënë në pah trendët kryesor në fushën e zhvillimit industrial në Kosovë.

Duke marrë parasysh faktin që ky Raport realizohet për aktivitetet ekonomike të zhvilluara në vitin 2016, fokusi i tij bie mbi këtë kohë, por trendët e indikatorëve të paraqitur përfshinë periudhën pesë vjeçare 2012-2016.

Ky Raport bazohet në të dhënat e mbledhura nga institucionet përgjegjëse (ASK, ARBK, ATK, BQK), kurse përpunimi, paraqitja grafike dhe analizimi i tyre është bërë nga Departamenti i Industrisë, përkatësisht, Divizioni për Politika Industriale (DPI).

Analiza Sektoriale 2016

Qarkullimi vjetor, të punësuarit dhe ndërmarrjet prodhuese

Analiza sektoriale në këtë raport përfshinë industrinë përpunuese, sipas NACE REV2, sektorët e radhitur prej numrit 10 deri në 33, e që ka të bëjë me numrin e ndërmarrjeve prodhuese, pastaj numrin e të punësuarve si dhe vlerën e qarkullimit vjetor në këta sektorë. Përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes, për këta indikatorë, në sektorët e industrisë, jo vetëm në vitin e fundit por edhe për periudhën krahasuese me vitin paraprak si dhe trendët në periudhën pesë vjeçare.

Nga analiza e këtyre të dhënave, sa i përket qarkullimit vjetor për vitin 2016, shohim se përpunimi i produkteve ushqimore (10) ka pasur përqindjen më të lartë, 18.8%, të qarkullimit në krahasim me sektorët e tjerë përpunues, përderisa në vitin e kaluar, 2015, ky sektor radhitej në vendin e dytë, me 17.6%. Gjatë këtij viti, ky sektor, gjithashtu me përqindjen më të lartë, 23.1% mbetet lider sa i përket numrit të të punësuarve si dhe numrit të ndërmarrjeve prodhuese me 26.65%.

Në vendin e dytë, si për nga vlera e qarkullimit vjetor po ashtu edhe për nga numri i të punësuarve radhitet sektori i prodhimit të produkteve minerale jo metalike me 18,3% përkatësisht me 14.9 %, përderisa tek numri i ndërmarrjeve prodhuese ky sektor zën vendin e katërt.

Një rritje e dukshme e vlerës së qarkullimit vërehet te sektori i prodhimit të gomës dhe plastikës me 14.2% nga 11.5% sa ishte në vitin paraprak. Ky sektor, që në listën e sektorëve të industrisë përpunuese, për nga vlera e qarkullimit, radhitet në vendin e tretë, shohim se ka shënuar rritje të vogël, me 0,3 %, edhe sa i përket numrit të të punësuarve si dhe numrit të ndërmarrjeve.

Të dhënat e paraqitura në tabelën nr. 1, tregojnë se sektori i prodhimeve të drurit dhe produkteve të drurit të tapës, radhitet në vendin e nëntë me 3.2%, por sa i përket numrit të ndërmarrjeve, me 10.2%. zën një vend të rëndësishëm në tabelë, të tretin me radhë. Kur jemi te ky sektor, shohim se prodhimi i mobileve është në një pozitë më të favorshme ku vlera e qarkullimit në këtë sektorë është 4.9%. ndërsa ka shënuar 7.8% të pjesëmarrjes në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe të punësuarve.

Vlera qarkulluese e sektorit të prodhimit të tekstilit, gjatë vitit 2016, është vetëm 1.4% e vlerës së përgjithshme, apo radhitet në vendin e 12 të tabelës kurse si sektor qëndron pak më mirë me numrin e të punësuarve ku radhitet në pozitën e nëntë me 3.2 % dhe në të tetin me numrin e ndërmarrjeve prodhuese me 2.5% të totali i përgjithshëm. I përafërt me këtë është edhe sektori i veshjeve, por që ka një vlerë shumë të vogël të qarkullimit me vetëm 0.7%.

Tabela 1: Sektori i Industrisë përpunuese sipas NACE REV2 2016

SEKTORI I INDUSTRISE PËRPUNUESE SIPAS NACE REV 2, për vitin 2016		Ndërmarrjet prodhuese		Numri i të punësuarave		Qarkullimi i vjetor	
		Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,226	26,5	5,440	23.1	170,917,867	18.8
11	Prodhimi i pijeve	74	1.6	1,559	6.6	95,645,500	10.5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	3	0.1	90	0.4	87,316	0.0
13	Prodhimi i tekstit	114	2.5	755	3.2	12,331,441	1.4
14	Prodhimi i veshjeve	208	4.5	631	2.7	6,224,289	0.7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	33	0.7	431	1.8	8,323,733	0.9
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës,	472	10.2	1,223	5.2	28,985,903	3.2
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	90	1.9	440	1.9	25,684,586	2.8
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	155	3.3	581	2.5	17,740,668	1.9
19	Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	4	0.1	12	0.1	2,549,037	0.3
20	Prodhimi i produkteve kimike	92	2.0	676	2.9	36,427,652	4.0
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve	10	0.2	95	0.4	2,493,822	0.3
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	466	10.1	2,349	10.0	129,758,635	14.2
23	Prodhimi i produkteve minerale jometalike	468	10.1	3,521	14.9	166,904,852	18.3
24	Prodhimi i metaleve	103	2.2	1,050	4.5	32,720,595	3.6
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	567	12.2	2,297	9.7	96,465,146	10.6
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	16	0.3	42	0.2	4,349,232	0.5
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	37	0.8	172	0.7	9,547,722	1.0
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	18	0.4	95	0.4	4,686,265	0.5
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysme rimorkiove	2	0.0	31	0.1	403,081	0.0
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	3	0.1	54	0.2	2,786,176	0.3
31	Prodhimi i mobilieve	363	7.8	1,843	7.8	45,023,000	4.9
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	71	1.5	159	0.7	6,835,487	0.8
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	36	0.8	49	0.2	4,396,029	0.5
	Gjithsej	4,631	100.0	23,595	100.0	911,288,034	100.0

Numri i të punësuarve sipas sektorëve të prodhimit industrial në nivel të Kosovës, 2012-2016


Analiza e të dhënave, sa i përket numrit të punësuarve, në sektorët industrial, përgjatë viteve 2012-2016, tregon se sektori i përpunimit të produkteve ushqimore është sektori me numër më të madhe të punësuarve në Kosovë dhe se ky sektor ka ruajtur një trend të rritjes së të punësuarve përgjatë këtyre viteve. Një rritje më e madhe vërehet në vitin 2013, nga 24.9%, sa ishte një vit më parë në 29.64% ndërsa të dhënat tregojnë se një rënie më e madhe ishte shënuar në vitin e kaluar, 22% të punësuar në këtë sektor, por që në vitin 2016 përsëri është shënuar një rritje e vogël për 4.6 % apo me 239 punësuar më shumë.

Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike, gjithashtu rezulton si sektor në të cilin janë të punësuar një numër më i madhe i punëtorëve. Të dhënat për pesë vitet e fundit tregojnë se nëpër vite kemi një rënie të lehtë për 4% apo nga 18.9%, sa ishte në vitin 2012 në 14.9% në vitin e fundit.

Të dhënat tregojnë se rritje të numrit të punësuarave, edhe pse jo e madhe, kemi në dy sektorë, në atë të prodhimit të produkteve të gomës dhe të plastikës, nga 8.8% në 10%, dhe tek sektori i prodhimeve të produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve nga 8% në 9.7%

Sektori i prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit dhe të tapës është njëri ndër sektorët i cili ka kontribuar në punësimin e punëtorëve në Kosovë në vazhdimësi. Në vitin 2012 nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në këtë sektor ishin të punësuar 6.5%. Ky trend është ruajtur edhe në vitin në vijim por në tri vitet e fundit vërehet një tendencë rënie e vogël, në rreth 5.2%. Një trend të ngjashëm e vërejmë edhe te sektori i prodhimeve të tekstitit, me rreth 4.5% të punësuarave në tri vitet e para, 2012-2014 dhe, siç shihet edhe në figurë kemi një rënie të vogël në vitin 2015, në 3.9% dhe po ashtu në 3.2% në vitin 2016.

Fig. 1. Numri i të punësuarve sipas sektorëve të prodhimit industrial në nivel Kosove sipas viteve, 2012-2016




Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve industrial në Kosovë, 2012-2016

Të dhënat për përqendrimin e ndërmarrjeve nëpër sektorë të ndryshëm industrial, sa i përket radhitjes së sektorëve, tregojnë se nuk kemi ndonjë ndryshim të madh të numrit të ndërmarrjeve në këto pesë vite. Viti 2012 dhe 2016 kanë shënuar shifrën prej rreth 4,700 ndërmarrje, përderisa një shifër më e lartë është shënuar në vitin 2014 me 5,259 ndërmarrje.

Të dhënat e paraqitura në figurën nr. 2, tregojnë për numrin e ndërmarrjeve prodhuese në rajonet e Kosovës, e që gjithsej është 4,631 në vitin 2016. Përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve prodhuese si dhe i të punësuarve është në rajonin e Prishtinës, pra në 1,146 ndërmarrje me 6,234 të punësuar. Analizat e të dhënave tregojnë se edhe në rajonet tjera të Kosovës e kemi një paralele të ngjashme në mes të numrit të ndërmarrjeve dhe të punësuarve.

Pas Prishtinës me një numër më të madh të ndërmarrjeve radhitet Gjilani me 1,179, pasuar nga Prizreni me 1,059, pastaj Peja me 867 dhe me numër më të vogël është Mitrovica, me 380 ndërmarrje.

Fig. 2. Numri i ndërmarrjeve, 2016, sipas rajoneve në Kosovë



Analiza makroekonomike

Bruto Produkti Vendor


Gjatë vitit 2016, ekonomia e Kosovës shënoi një rritje të njëjtë me atë të vitit të kaluar, shikuar nga qasja e shpenzimeve. Në fakt, BPV u rrit 214 milion euro, dhe me këtë rast vlera totale e saj u rrit nga 5,771 milion euro, sa ishte në vitin 2015 në euro 5,985 milion në vitin 2016.

Tabela 2: BPV, 2012-2016

Viti	BPV (me çmime aktuale, në milion euro)	Ndryshimi vjetor i BPV-së (me çmime aktuale, në milion euro)
2012	5,059	244
2013	5,327	268
2014	5,567	240
2015	5,771	204
2016	5,985	214

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 3, përgjatë pesë viteve të fundit, BPV kishte shënuar një trend pozitiv, duke shënuar rritjen më të lartë (5.3%) në vitin 2013. Shkalla e rritjes së BPV-së për vitin 2016 në krahasim me vitin paraprak ishte për 3.7%, ngjashëm me atë të vitit të kaluar.

Figura 3: Norma e rritjes së BPV-së




Kontribuuesit kryesor në BPV-në e vitit 2016, kanë vazhduar të jenë të ngjashëm me ata në vitet paraprake, duke filluar me shpenzimet e konsumit final të ekonomive familjare, ndjekur nga kapitali bruto i formuar, dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve si dhe shpenzimet e konsumit të Qeverisë.

Ndërkaq, komponenti kryesor makroekonomik që ndikoi negativisht në vlerën e përgjithshme të BPV-së, ashtu sikurse edhe në vitet paraprake, ishte importi i mallrave dhe shërbimeve, që përfaqësoi 51.3% të BPV-së.

Nga Figura 4, mund të shihen komponentët kryesorë të BPV-së gjatë vitit 2016; në këtë drejtim vlen të theksohet se nuk vërehet ndonjë ndryshim në renditjen e tyre, shikuar nga këndi i pjesëmarrjes së tyre në vlerën e përgjithshme të BPV-së.

Figura 4: Komponentët e BPV-së, sipas qasjes së shpenzimeve, 2016



- Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake & IJPSHESH
- Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë
- Formimi i bruto kapitalit
- Eksporti neto

Sidoqoftë, trendët e vlerave të atyre komponentëve ishin të ndryshëm. Më konkretisht, përderisa vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve u rrit për 72 milion euro, ajo e importit të tyre shënoi një ngritje prej 146 milion euro, duke rezultuar me një deficit tregtar më të lartë prej 74 milion euro, në krahasim me vitin paraprak.

Në anën tjetër, vlera e Bruto Kapitalit u rrit për rreth 50 milion euro, përderisa shpenzimet e Qeverisë u zvogëluan për 10 milion euro.

Njëkohësisht, konsumi final i ekonomive shtëpiake, që tradicionalisht paraqet komponentin e BPV-së me vlerën më të lartë (rreth 86.5% të BPV-së), shënoi ngritjen relativisht më të lartë prej rreth 212 milion euro.

Tabela 3: Struktura e BPV-së sipas shpenzimeve 2012-2016 (në milion euro)

	2016	2015	2014	2013	2012
Shpenzimet e konsumit final	6,060	5,858	5,731	5,331	5,320
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake & IJPSHESH	5,176	4,964	4,821	4,467	4,478
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	884	894	910	864	842
Formimi i Bruto Kapitalit	1,651	1,601	1,435	1,471	1,465
Eksporti neto	(1,726)	(1,652)	(1,599)	(1,476)	(1,727)
Eksporti I mallrave dhe shërbimeve	1,346	1,274	1,253	1,167	922
Importi I mallrave dhe shërbimeve	3,072	2,926	2,852	2,642	2,649
BPV	5,985	5,807	5,568	5,327	5,059

Struktura e përgjithshme e të Hyrave të Qeverisë 2015-2016

Struktura e të hyrave qeveritare, që përfshinë dymbëdhjetë kategori, përgjatë vitit 2016, krahasuar me vitin paraprak, pësoi disa luhatje në kuadër të disa kategorive të caktuara. Më saktësisht, ngritjet më të mëdha të të hyrave ngjanë tek tatimet në produkte (126.22 milion euro); ky ishte rezultat i ngritjes së të hyrave kryesisht nga TVSH (80.07 milion euro), tatimi dhe dogana në importe duke përjashtuar TVSH-në (40.91 milion euro). Ngritja tjetër, relativisht më e lartë e të hyrave qeveritare, ngjau tek kategoria e tatimeve rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj. (30.93 milion euro), si dhe tek pagesat për shitjet (14.68 milion euro).

Siç paraqitet edhe në tabelën e poshtëshënuar, përveç ngritjeve u shënuan edhe uljet relativisht të mëdha të të hyrave qeveritare të cilat ndodhën tek kategoria e aktiviteteve dhe detyrimeve financiare (73.09 milion euro), pastaj tek kategoria e tatimeve tjera në prodhim (11.49 milion euro) si dhe transferet e tjera aktuale (4.656 milion euro).


Tabela 4: Struktura e përgjithshme e të Hyrave të Qeverisë 2015-2016

Kategoria e te hyrave	2015	2016
Tatimet në produkte	1,093.9	1,220.1
Tatimi mbi vlerën e shtuar(TVSH)	584.3	664.4
Tatimi dhe dogana ne importe duke përjashtuar TVSH	486.5	527.4
<i>Detyrimet e importit</i>	130.7	129.9
<i>Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet</i>	355.8	397.5
Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	23.1	28.3
Tatimet tjera në prodhim	57.9	46.4
Të hyrat nga prona	16.5	7.2
Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	205.1	236.0
Transferat e tjera aktuale	27.8	23.1
Aktivet dhe detyrimet financiare	227.8	154.8
Pagesat për output jo-tregut (Shitjet)	77.0	91.7
Gjithsej	1,706.1	1,779.3

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, gjatë vitit 2016 pësuan një rënie të dukshme, pas rritjes relativisht më të lartë që u arrit një vit më parë. Më konkretisht, gjatë asaj periudhe kohor, ashtu siç mund të vërehet në Figurën nr. 5, vlera e tyre pësoi një rënie prej rreth 30%.

Figura 5: Investimet e Huaja Direkte (në mil. euro)



Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik

Gjithashtu, nga Tabela nr. 4 mund të shihet që IHD në Kosovë gjatë vitit 2016 arritën vlerën prej 215.8 milion euro. Sektori më tërheqës për investimet e huaja direkte sërish ishte ai patundshmërive, i cili arriti të thith rreth 38% të vlerës së përgjithshme. Sektorë të tjerë me vlerën më të lartë të IHD-ve të thithura ishte ai i ndërtimitarisë me 6.4%, ndjekur nga ai i shërbimeve financiare me 6.3%.

Në të njëjtën kohë, krahasuar me vitin paraprak, vlera më e lartë e IHD-ve ishte në sektorin e shërbimeve financiare me rreth 45.3 milion euro, ndjekur nga ai i patundshmërive me 22 milion euro, ndërtimitarisë me 18 milion euro dhe minierave prej rreth 15.4 milion euro.


Tabela 4: IHD sipas sektorëve ekonomike, 2012 – 2016 (në milion euro)

Sektori	2012	2013	2014	2015	2016
Bujqësia	0.3	0.4	0.2	1.0	1.5
Minierat	-25.0	-14.1	4.2	-36.9	-22.1
Industria	27.4	11.5	-34.0	20.7	5.3
Energjia	2.2	48.8	13.4	11.9	3.4
Ndërtimtaria	31.1	17.3	-19.9	46.3	28.2
Shërbimet tregtare	9.3	14.6	8.4	12.0	12.8
Hotelet	0.5	0.8	0.4	0.0	0.7
Transporti dhe Komunikimi	32.4	51.0	-9.1	-6.1	-9.4
Shërbimet financiare	22.4	4.4	41.9	64.3	19.0
Patundshmëritë	115.7	136.1	142.1	189.6	167.6
Shërbimet tjera	1.8	3.3	2.2	4.5	9.4
Aktivitetet tjera	11.0	6.2	1.4	1.4	-0.6
Gjithsej	229.1	280.2	151.2	308.8	215.9

Në anën tjetër, vlera e IHD-ve gjatë vitit 2016 në sektorin e industrisë pësoi një rënie të dukshme krahasuar me vitin paraprak. Për më shumë një rënie e tillë është relativisht e dukshme, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kur vlera përkatëse ishte 20.7 milion euro, që nënkupton se gjatë vitit 2016 pati një rënie prej rreth 75% të IHD-ve në këtë sektor ekonomik.

Në fakt, ashtu siç edhe mund të vërehet në Figurën e mëposhtme, vlera e IHD-ve në sektorin e industrisë, shënoi vlerën më të ulët që nga viti 2007, në vetëm 5.3 milion euro apo vetëm 1.2% e vlerës së përgjithshme të IHD-ve të periudhës përkatëse.

Figura 6: IHD, 2012-2016




Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas Shteteve

Duke qenë se vlera e përgjithshme e IHD-ve gjatë vitit 2016 krahasuar me viti paraprak kishte pësuar një rënie relativisht të dukshme, edhe vlera e atyre investimeve, nga pothuajse të gjitha shtetet e origjinës, po ashtu shënoi rënie. Në fakt, IHD prej shteteve sikurse Zvicra, Turqia, Shqipëria, dhe Gjermania, të cilat përfaqësojnë burimet e tyre me vlerat relativisht më të mëdha, shënuan një rënie relativisht të dukshme.

Për më shumë, ashtu siç mund të shihet në figurën e mëposhtme, origjina e IHD-ve në Kosovë, ngjashëm me vitet paraprake, ishte relativisht e njëjtë edhe gjatë vitit 2016.

Figura 7. IHD sipas vendeve të origjinës, 2012-2016



Sidoqoftë, analizuar në terme nominale, krahasuar me vitin paraprak, IHD-të që shënuan rënien më të madhe ishin ato prej shtetit të Austrisë (23.56 milion euro), pasuar nga ato të shtetit të Gjermanisë (19.59 milion euro) dhe Britania e Madhe (13 milion euro).

Tabela 5: IHD sipas vendeve të origjinës, 2012 – 2016 (në euro milion)

	2012	2013	2014	2015	2016
Zvicra	43.8	41.7	38.2	72.9	61.8
Turqia	65.6	88.6	20.0	55.4	44.4
Shqipëria	4.7	19.3	20.4	40.1	28.6
Gjermania	49.5	21.7	29.4	45.3	25.7
Tjera	23.6	25.2	16.6	22.4	23.3
SHBA	10.8	12.7	14.7	25.0	22.6
Anglia	14.3	10.7	-39.5	26.6	13.6
Austria	0.4	10.7	30.3	33.5	9.9
Emiratet Arabe	0.8	-0.8	1.3	1.4	3.5
Norvegjia	2.9	4.7	5.9	2.9	3.4
Maqedonia	1.2	4.6	3.2	0.1	3.2
Franca	6.3	3.8	3.3	3.2	2.8
Kanada	1.2	1.2	0.9	1.1	2.5
Italia	4.4	8.7	3.3	5.7	1.9
Bosnja	0.0	0.2	0.3	0.8	1.2
Slovakia	-	0.2	0.1	0.1	0.8
Luksemburgu	0.8	2.3	1.2	0.1	0.6
Bullgaria	8.1	5.6	14.5	1.6	0.4
Qipro	0.3	0.3	0.3	0.1	0.4
Kuvajti	0.7	2.0	0.5	0.0	0.2
Estonia	0.2	0.2	0.1	-0.8	0.2
Republika Ceke	0.3	0.2	0.4	1.3	0.2
Mali i Zi	4.3	3.1	0.1	0.1	0.1
Egjipti	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0
Greqia	0.3	-0.4	-0.6	-0.2	-0.4
Rusia	0.4	5.7	2.4	0.8	-0.6
Hungaria	0.4	1.3	1.1	0.1	-1.7
Slovenia	9.3	7.0	-9.4	5.6	-4.5
Holanda	-25.6	-0.1	-7.8	-36.4	-28.4
Gjithsej	229.1	280.2	151.2	308.8	215.9

Tregu financiar

Sa i përket qasjes në kapitalin financiarë, gjatë vitit 2016 u shënuan norma relativisht të njëjta të interesit të pothuajse të të gjitha llojeve të kredive sikurse gjatë pesë viteve të fundit. Tri llojet e kredive me normën më të lartë të interesit ishin kreditë bujqësore, ndjekur nga ato konsumuese dhe industriale.


Në listën e variacioneve të interesit të kredive, rënia më e theksuar e normave të interesit u shënuan në rastin e kredive bujqësore, shërbyese dhe industriale. Në anën tjetër, vetëm në rastin e kredive konsumuese pati një ngritje relativisht të ulët të normës së interesit.

Tabela 6: IHD sipas vendeve të origjinës, 2012 – 2016 (në euro milion)

	2012	2013	2014	2015	2016		
Kredi të reja	14.24	14.22	14.12	14.15	14.14		
Kredi konsumuese	12.70	12.75	12.76	12.75	12.77		
Kredi hipotekare	11.71	11.71	11.67	11.65	11.65		
Bujqësore	25.48	25.66	25.26	24.87	24.27		
Industriale	13.46	13.68	13.65	13.76	13.61		
Shërbyese	14.01	13.74	13.59	13.17	12.97		

Norma e interesit të kredive industriale në vitin 2016 ishte më e ulëta qysh nga viti 2013, ashtu edhe siç shihet në figurën e mëposhtme, ishte një trend me rënie të vazhdueshme. Sidoqoftë, normat përkatëse të interesit janë relativisht të larta krahasuar me sektorët jo-prodhues (shërbyes, konsumues dhe hipotekare).

Figura 8: Normat e interesit, 2012-2016 (në %)



Indeksi i Çmimeve


Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe i importit shënoi një rritje relativisht të vogël gjatë vitit 2016 në krahasim me vitin bazë (2010) se sa gjatë vitit paraprak. Ndërkaq, një trend i tillë nuk u reflektua njëtrajtshëm edhe në rastin e indeksit të çmimeve të konsumit, pasi që indeksi i tyre gjatë vitit 2016 arriti një vlerë relativisht më të lartë në krahasim me vitin paraprak (2015), e që njëkohësisht është marrë edhe si çmimi bazë prej ASK-së.

Tabela 7: Indekset e çmimeve të prodhimit, konsumit dhe importit, sipas viteve 2012-2016

Viti	IÇP (2010 ë 100)	IÇI (2010ë100)	IÇK(2015 ë 100)
2012	106.6	115.0	98.4
2013	109.1	115.2	100.1
2014	110.9	114.7	100.5
2015	113.9	114.7	100
2016	113.8	110.5	100.3

Nga figura e mëposhtme mund të vërehet që sa i përket indeksit të çmimeve të konsumit, edhe gjatë vitit 2016, ky indeks vazhdoi trendin e tij relativisht më të qëndrueshëm prej të tri këtyre indekseve. Një gjë e tillë nuk mund të thuhet për IÇI, pasi që përkundër faktit që nga viti 2012 deri në vitin 2015 kishte shënuar një qëndrueshmëri relative, gjatë vitit 2016 shënoi një rënie të dukshme. Në anën tjetër, trendi i IÇP qysh nga viti 2012 shënoi një rritje të vazhdueshme. Rrjedhimisht, një ndërlidhje e këtyre indekseve mund të interpretohet në atë se çmimet e konsumit janë kryesisht të dominuara nga çmimet e importeve, sidomos kur kemi parasysh faktin që ato arrijnë rreth 51% të vlerës së përgjithshme të konsumit final në Kosovë. Pra, këto të dhëna tregojnë se oferta e mallrave dhe shërbimeve të importuara është jo-elastike ndaj kërkesës përkatëse vendore, ndërkohë që oferta nga prodhuesi i mallrave dhe shërbimeve të Kosovës ballafaqohet me çmime të prodhimit që shënojnë rritje të vazhdueshme, duke shërbyer si një faktorë për uljen e konkurrueshmërisë në tregun vendor, në veçanti.

Figura 9 : Ndryshimet vjetore të çmimeve të Prodhimit, Konsumit dhe Importit, 2012-2016



Tregtia e Jashtme


Tabela 8: Vlera e Eksporteve, Importeve dhe bilanci tregtar në Kosovë (000')

Vitet	Eksportet	Importet	Bilanci Tregtar	Ndryshimi ne %
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	3%
2013	293,842	2,449,064	-2,155,222	-3%
2014	324,543	2,538,337	-2,213,794	3%
2015	335,076	2,634,693	-2,299,617	4%
2016	306,053	2,789,490	-2,483,437	8%

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet se nga viti 2012 deri në vitin 2016 bilanci tregtar në Kosovë është negativ. Në pesë vitet e fundit ky bilanc ka vazhduar të rritet vazhdimisht me përjashtim të vitit 2013 ku bilanci negativ ka shënuar një rënie prej 3% krahasuar me vitin 2012.

Sa i përket vitit 2016, bilanci negativ ka shënuar një vlerë prej 2 miliard e 483 milion euro, duke shënuar një rritje prej 8% e cila rezulton të jetë më e madhja në pesë vitet e fundit. Ky bilanc për vitin 2016 vjen kryesisht si rezultat i zvogëlimit të eksporteve të ekonomisë së Kosovës me 9% nga viti paraprak.

Figura 10: Tregtia e jashtme 2016



Gjithashtu, siç mund të vërehet edhe nga grafikoni, vlerat e importeve dominojnë tregtinë e jashtme të Kosovës kundrejt vlerave më të vogla të eksporteve në pesë vitet e fundit. Këto rezultate kanë shënuar një trend negativ të bilancit tregtar por që vlera më e ulët u shënuar në vitin 2016.

Ndërkohë, industria e Kosovës kryesisht me sektorët më dominues (metali, tekstili, druri, industria kimike, plastikë e gomë, lëkurë, letër e këpuçë) ka shënuar këto vlera të tregtisë së jashtme për vitin 2016: Eksporti ka arritur vlerën prej 239,582,459 euro ndërsa importi ka arritur vlerën prej 1,306,924,769 euro.

Tabela 9: Vlera e Eksp. dhe Imp. me vendet e CEFTA-së, BE-së, dhe Vendet tjera 2015 - 2016

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimike	44,484,270	68,588,056	24,103,786	54.2	617,988,143	549,055,605	(68,932,538)	(11.2)
Plastik dhe gomë	23,470,026	28,871,840	5,401,814	23.0	163,166,193	188,422,517	25,256,324	15.5
Lëkurë	10,769,339	11,192,265	422,927	3.9	7,602,101	8,392,124	790,024	10.4
Drurit	2,462,806	3,618,533	1,155,728	46.9	62,448,694	72,641,885	10,193,190	16.3
Letër	2,826,271	3,977,220	1,150,948	40.7	38,738,567	41,741,640	3,003,073	7.8
Tekstilit	11,956,696	8,784,388	(3,172,308)	(26.5)	122,588,622	136,687,770	14,099,149	11.5
këpucë etj.	3,030,777	3,371,345	340,569	11.2	30,594,320	35,017,027	4,422,708	14.5
Metaleve	157,731,983	111,178,812	(46,553,171)	(29.5)	260,547,796	275,383,592	14,835,796	5.7
Gjithsej	256,732,167	239,582,459	(17,149,708)	(6.7)	1,303,674,436	1,307,342,161	3,667,726	0.3

Të dhënat e paraqitura më sipër, në tabelën nr. 9, paraqesin një pasqyrë të vlerave të importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së, BE-së dhe vendet e tjera për vitin 2016 dhe vitin 2015.

Vërejmë se janë sektorët e ngjashëm të industrisë së Kosovës të cilët vazhdojnë ta dominojnë tregtinë e jashtme, për këtë periudhë kohore, e këtu mund të veçojmë sektorin e metaleve, industrinë kimike dhe sektorin plastikë e gomë.

Sektorin që ka eksportuar më shumë gjatë vitit 2016 është sektori i metaleve duke arritur vlerën prej 111,178,812 euro. Megjithatë, ky sektor ka eksportuar 29.5% më pak, në vlerë, krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, vërejmë se sektori me rritjen më të lartë sa i përket eksporteve, për vitin 2016, është sektori i drurit i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 46.9% krahasuar me vitin paraprak, kurse sektori i letrës radhitet në vendin e dytë me shtimin e vlerës së eksporteve, krahasuar me vitin paraprak, duke i rritur ato për vitin 2016 me 40.7%.

Në anën tjetër importet vazhdojnë të dominohen nga sektori i industrisë kimike duke shënuar vlerën prej 549,055,605 euro për vitin 2016. Edhe pse ky sektor dominon me importet më të larta për vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak, vlera e importeve për këtë sektor ka pasur një ulje prej 11.2%, e që rezultojnë të jetë më e larta për këtë vit. Vendin e dytë, sa i përket importeve më të mëdha, e zë sektori i metalit me një vlerë prej 275,383,592 euro, duke pësuar një ngritje prej 5.7% krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, sektori që ka shënuar rritjen më të madhe të importeve krahasuar me vitin paraprak është sektori i drurit ku importet kanë shënuar vlerën prej 72,641,885 euro për vitin 2016 duke arritur një rritje me 16.3% krahasuar me vitin 2015.

Në përgjithësi, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar në tregtinë e jashtme në vlerë prej 1,067,759,702 euro, ku për vitin 2016 eksportet janë ulur me 6.7% kundrejt rritjes në vlerë të importeve me 0.3%.

Tabela 10: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për vitin 2015 - 2016

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimike	33,161,660	44,994,845	11,833,185	35.7	219,649,241	164,715,258	(54,933,983)	(25.0)
Plastik dhe gomë	8,690,895	9,532,071	841,176	9.7	34,626,086	42,575,654	7,949,568	23.0
Lëkurë	1,983,233	3,342,837	1,359,604	68.6	69,314	95,720	26,406	38.1
Drurit	808,093	1,029,611	221,518	27.4	26,320,249	29,477,410	3,157,161	12.0
Letre	2,306,237	2,997,419	691,181	30.0	16,374,766	17,273,454	898,688	5.5
Tekstilit	921,145	783,344	(137,801)	(15.0)	4,002,171	5,098,533	1,096,362	27.4
Këpucë etj.	1,894,042	1,473,694	(420,348)	(22.2)	1,813,625	1,849,701	36,076	2.0
Metaleve	38,768,487	41,747,966	2,979,479	7.7	136,999,417	152,696,633	15,697,216	11.5
Gjithsej	88,533,792	105,901,787	17,367,995	19.6	439,854,870	413,782,363	(26,072,507)	(5.9)

Në tabelën numër 10 pasqyrohen vlerat e importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-s për vitin 2016 dhe vitin paraprak për sektorët e industrisë kimike, plastik-gomë, lëkure, dru, letër, tekstil, këpucë, dhe metal. Vërejmë se janë po të njëjtët sektorë të industrisë së Kosovës të cilët vazhdojnë të dominojnë edhe tregtinë e jashtme me vendet e CEFTA-së.

Spektori që ka eksportuar më shumë gjatë viti 2016 është sektori i industrisë kimike duke arritur vlerën prej 44,994,845 euro. Ky sektor ka eksportuar 35.7% më shumë, në vlerë, krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu vërejmë se sektori me rritjen më të lartë sa i përket eksporteve për vitin 2016 është sektori i lëkurës i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 68.6% krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa sektori i artikujve për këpucë është sektori që ka zvogëluar më shumë në vlerë eksportet krahasuar me vitin paraprak duke i zvogëluar ato për vitin 2016 me 22.2%.

Në anën tjetër importet vazhdojnë të dominohen nga sektori kimik duke kapur vlerën prej 164,715,258 euro për vitin 2016. Edhe pse ky sektor dominon me importet më të larta për vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak vlera e importeve për këtë sektor ka pasur një ulje prej 25%, ulje kjo që rezulton të jetë me e larta për këtë vit. Vendin e dytë sa i përket importeve më të mëdha e zë sektori i metalit me një vlerë prej 152,696,633 euro, duke pësuar një rritje prej 11.5% krahasuar me vitin paraprak. Ndërkohë, sektori që ka pësuar rritjen më të madhe të importeve krahasuar me vitin paraprak është sektori i artikujve të lëkurës ku importet arrijnë vlerën prej 26,406 euro për vitin 2016 duke shënuar një rritje me 38.1% krahasuar me vitin 2015.

Në përgjithësi, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e CEFTA prej 396,414,368 euro, megjithatë, eksportet për vitin 2016 në vlerë janë rritur me 19.6% kundrejt zvogëlimit të importeve me 5.9%.

Tabela 11: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së për vitin 2015 – 2016

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimike	8,355,897	14,575,414	6,219,517	74.4	320,697,551	303,937,708	(16,759,843)	(5.2)
Plastik dhe gomë	8,610,543	13,314,870	4,704,326	54.6	67,336,835	78,597,239	11,260,404	16.7
Lëkurë	8,593,131	7,728,689	(864,442)	(10.1)	1,327,783	1,436,804	109,021	8.2
Drurit	908,211	1,398,525	490,314	54.0	27,434,629	27,817,321	382,692	1.4
Letre	227,230	213,061	(14,169)	(6.2)	15,123,740	15,882,997	759,257	5.0
Tekstilit	6,484,303	2,800,035	(3,684,268)	(56.8)	12,566,150	12,040,183	(525,967)	(4.2)
Këpucë etj.	1,079,525	1,858,039	778,515	72.1	2,973,149	3,293,939	320,790	10.8
Metaleve	49,813,803	7,946,484	(41,867,320)	(84.0)	58,529,201	59,791,503	1,262,302	2.2
Gjithsej	84,072,643	49,835,117	(34,237,526)	(40.7)	505,989,038	502,797,693	(3,191,345)	(0.6)

Të dhënat e paraqitura më sipër në tabelën 11, tregojnë për vlerat e importit dhe eksportit me vendet e BE-së për vitin 2016 dhe vitin paraprak.

Sektori që ka eksportuar më shumë gjatë viti 2016, edhe me vendet e BE-së është ai kimik duke arritur vlerën prej 14,575,414 euro. Ky sektor ka eksportuar 74.4% më shumë, në vlerë, krahasuar me vitin paraprak si dhe ka shënuar rritjen më të lartë krahasuar dhe me sektorët e tjerë. Gjithashtu vërejmë se sektori i dytë me rritjen më të lartë sa i përket eksporteve për vitin 2016 është sektori i artikujve për këpucë i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 72.2%, krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa sektori i metaleve, krahasuar me vitin paraprak, ka zvogëluar eksportet për vitin 2016 me 84%.

Në anën tjetër importet vazhdojnë të dominohen nga sektori i industrisë kimike duke shënuar vlerën prej 303,937,708 euro për vitin 2016. Edhe pse ky sektor dominon me importet më të larta për vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak vlera e importeve për këtë sektor ka pësuar një ulje prej 5.2%, ulje kjo që rezulton të jetë më e larta për këtë vit. Vendin e dytë, sa i përket importeve më të mëdha e zë sektori plastik dhe gomë me një vlerë prej 78,597,239 euro, duke pësuar një rritje prej 16.7% në krahasim me vitin paraprak. Ky sektor gjithashtu është edhe sektori që ka treguar rritjen më të madhe të importeve krahasuar me vitin paraprak.

Në total, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e BE-së duke arritur një vlerë prej 452,962,576 euro. Eksportet për vitin 2016 u ulën me 40.7% , ne krahasim me importet të cilat pësuan një ulje më të vogël prej vetëm 0.6%.

Tabela 12: Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2015 - 2016

Artikujt sipas industrisë	Eksporti		Balanci		Importi		Balanci	
	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %	2015	2016	Ndryshimi	Ndryshimi %
Kimik	2,966,712	9,017,797	6,051,084	204.0	77,641,351	76,626,683	(1,014,668)	(1.3)
Plastik dhe gomë	6,168,587	6,024,899	(143,688)	(2.3)	61,203,272	67,342,159	6,138,887	10.0
Lëkure	192,975	120,739	(72,236)	(37.4)	6,205,004	6,859,659	654,655	10.6
Druri	746,502	1,190,381	443,879	59.5	8,693,817	15,364,278	6,670,462	76.7
Letre	292,805	766,740	473,936	161.9	7,240,062	8,773,091	1,533,029	21.2
Tekstili	4,551,248	5,201,009	649,761	14.3	106,020,301	119,550,408	13,530,107	12.8
Këpucë etj.	57,210	39,612	(17,598)	(30.8)	25,807,545	29,871,117	4,063,572	15.7
Metaleve	69,149,693	61,484,363	(7,665,330)	(11.1)	65,019,177	62,501,332	(2,517,845)	(3.9)
Gjithsej	79,579,036	83,845,539	4,266,503	5.4	357,830,528	386,888,726	29,058,198	8.1

Të dhënat e tabelës numër 12, tregojnë një pasqyrë të vlerave të importit dhe eksportit me vendet e tjera për vitin 2016 dhe vitin paraprak për të njëjtët sektorë.

Sektori që ka eksportuar më shumë gjatë viti 2016 në vendet e tjera është sektori metaleve duke arritur vlerën prej 61,484,363 euro. Megjithatë, ky sektor ka eksportuar 11.1 % me pak, në vlerë, krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, vërejmë se sektori me rritjen më të lartë, sa i përket eksporteve për vitin 2016, është sektori kimik i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 204 % krahasuar me vitin paraprak duke arritur eksportet në vlerë prej 9,017,797 euro në vitin 2016 nga 2,966,712 euro që ishin në vitin 2015. Ndërsa sektori artikuj prej lëkure, është sektori që ka zvogëluar më shumë në vlerë eksportet krahasuar me vitin paraprak me 37.4%. për vitin 2016.

Në anën tjetër importet vazhdojnë të dominohen nga sektori i tekstilit duke rritur vlerën prej 119,550,408 euro për vitin 2016. Edhe pse ky sektor dominon me importet më të larta për vitin 2016, krahasuar me vitin paraprak, vlera e importeve për këtë sektor është rritur me vetëm 12.8 %. Në vendin e dytë sa i përket importeve më të mëdha radhitet sektori kimik me një vlerë prej 76,626,683 euro, edhe pse duke pësuar një ulje prej 1.3% krahasuar me vitin paraprak. Sektori që ka pësuar rritjen më të lartë të importeve krahasuar me vitin paraprak është sektori i drurit ku importet rezultojnë të rritura me 76.7%. Anasjelltas, sektori që ka pësuar uljen më të madhe të importeve krahasuar me vitin paraprak është sektori i metalit ku për këtë kategori importet u zvogëluar me 3.9%.

Në total, vërejmë se vazhdojmë të kemi një deficit tregtar me vendet e tjera duke arritur një vlerë prej 303,043,187 euro. Eksportet për vitin 2016 u rritën me 5.4% më ngadalë në krahasim me importet të cilat u rriten me 8.1% në këtë kategori të tregtisë së jashtme të Kosovës.

Fuqia punëtore


Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjatë vitit 2016 arriti në 38.7%. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit relativisht dukshëm, prej 1.1%, në krahasim me vitin 2015. Të dhënat tregojnë se rritja më e theksuar e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore rezultoi në rastin e meshkujve ku kishte një rritje prej 1.6 % si dhe 0.5 % në rastin e femrave.

Tabela 13: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2016

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (në %)	40.5%	36.9%	41.6%	37.6%	38.7%
Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore (në %)	21.1%	17.8%	21.4%	18.1%	18.6%
Pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore (në %)	60.2%	55.4%	61.8%	56.7%	58.3%

Nga Figura 11, mund të shihet që shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjatë pesë viteve të fundit, ka pësuar luhatje nga viti në vit, duke konsideruar vlerën më të lartë prej 41.6% në vitin 2014, dhe atë me ulët prej 36.9% në vitin 2013.

Figura 11: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2012-2016




Ndërsa, shkalla e përgjithshme e papunësisë shënojë një rënie krahasuar me vitin paraprak duke arritur në 27.5% gjatë vitit 2016. Një e dhënë e tillë paraqet një shkallë më të ulët prej 5.4% krahasuar me vitin 2015. Rënia e shkallës së përgjithshme të papunësisë ishte si rrjedhojë e rënies së shkallës së papunësisë tek femrat me 4.8% dhe tek meshkujt me 5.6%.

Tabela 14: Shkalla e papunësisë 2012-2016

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Shkalla e papunësisë e përgjithshme (në %)	30%	31%	35.3%	32.9%	27.5%
Shkalla e papunësisë tek femrat (në %)	38%	40%	41.6%	36.6%	31.8%
Shkalla e papunësisë tek meshkujt (në %)	27%	28%	33.1%	31.8%	26.2%

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 13, trendi i shkallës së papunësisë në krahasim me vitin paraprak shënoi një rënie, duke shënuar kështu nivelet më të ulëta në katër vitet e fundit. Vlen të theksohet që krahasuar me vitin paraprak, gjatë vitit 2016, shkalla e papunësisë tek femrat pësoi një rënie nga 36.6 % në 31.8 %, ndërsaq tek meshkujt nga 33.8% në 26.2%.

Figura 13: Shkalla e papunesisë 2012-2016



Konkluzione:

- Gjatë vitit 2016, në sektorët e industrisë, kemi 29.395 të punësuar në 4.631 ndërmarrje dhe me vlerë të qarkullimit prej 911,288,034 euro. Sektori i përpunimit të produkteve ushqimore (10) ka shënuar përqindjen më të lartë, 18.8%, sa i përket qarkullimit vjetor, për vitin 2016 në krahasim me sektorët e tjerë përpunues të NACE2. Gjithashtu me përqindjen më të lartë, 23.1% ky sektor mbetet lider sa i përket numrit të të punësuarve si dhe numrit të ndërmarrjeve prodhuese me 26.65%.
- Sa i përket numrit të të punësuarve 2012-2016 të dhënat tregojnë se kemi rritje të lehtë të numrit të punësuarave në dy sektorë, në atë të prodhimit të produkteve të gomës dhe të plastikës, nga 8.8% në 10%, dhe tek sektori i prodhimeve të produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve nga 8% në 9.7%
- Sektori me rritjen më të lartë, sa i përket eksporteve, për viti 2016, është sektori i drurit i cili e ka rritur vlerën e eksporteve me 46.9% krahasuar me vitin paraprak, kurse sektori i letrës radhitet në vendin e dytë pasi që ka shtuar vlerën e eksporteve krahasuar me vitin paraprak për 40.7%. Ndërsa sektori i industrisë kimike dominon me importet më të larta për vitin 2016 edhe pse është shënuar një prej 11.2%, krahasuar me vitin paraprak.
- Vlera e përgjithshme e IHD-ve gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin paraprak ka pësuar rënie relativisht të dukshme, me rreth 30%, që do të thotë se edhe vlera e investimeve, nga pothuajse të gjitha shtetet e origjinës, shënoi rënie.
- Sa i përket qasjes në kapitalin financiarë, gjatë vitit 2016 u shënuan norma relativisht të njëjta të interesit të pothuajse të të gjitha llojeve të kredive sikurse gjatë pesë viteve të fundit. Tri llojet e kredive me normën më të lartë të interesit ishin kreditë bujqësore, ndjekur nga ato konsumuese dhe industriale edhe pse shohim se norma e interesit të kredive industriale ka një trend të uljes që nga viti 2013 dhe ishte më e ulëta në vitin 2016.
- Çmimet e konsumit në Kosovë janë të dominuara, kryesisht, nga çmimet e importeve. Të dhënat tregojnë se oferta e mallrave dhe shërbimeve të importuara është jo-elastike ndaj kërkesës përkatëse vendore, ndërkohë që oferta nga prodhuesi i mallrave dhe shërbimeve të Kosovës ballafaqohet me çmime të prodhimit që shënojnë rritje të vazhdueshme, andaj është faktorë që ndikon në uljen e konkurrueshmërisë në tregun vendor.
- Shkalla e përgjithshme e papunësisë shënojë një rënie krahasuar me vitin paraprak nga 32.9% në 27.5%, në vitin 2016, që paraqet një rënie të shkallës së përgjithshme për 5.4% (tek femrat me 4.8% dhe tek meshkujt me 5.6%).